

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departementi i përgjithshëm, Divizioni civil,** sipas gjyqtarës Mevlide Shabani, me bashkëpunëtoren profesionale Vlora Selmani - Rahimi, në çështjen juridiko - civile të paditëses K.E.K, të cilën e përfaqëson juristi D. R nga Gj kundër të paditurit M. H nga fshati Llashticë Komuna e Gjilanit, për pagimin e borxhit, në seancën kryesore dhe publike të mbajtur më dt. 10.03.2017 bie këtë

## **A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditëses KEK., kundër të paditurit M. H nga fshati Ll. K. e Gj dhe

**II.URDHËROHET** i padituri që në bazë të dokumentit autentik faturës nr..... të përmbush borxhin paditëses në shumë prej 877.43 €.

**III. DETYROHET** i padituri, që paditëses t,ja paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore në vlerë prej 20 €.

## **A r s y e t i m**

Në Gjykatën Themelore në Gjilan, fillimisht është paraqitur propozim për përmburim nga ana e Kreditorit Korportata Energjetike e Kosovës, kundër debitorit M. H, me propozim për ekzekutim të shumës së borxhit në vlerë prej ...€, mirëpo kundër aktvendimit E.nr.551/12 te dates 24.10.2013 ka ushtruar kundërshtim, ndërkaq gjykata me aktvendimin e datës 18.02.2014 propozimin e kreditorit e ka konsideruar si padi .

Gjykata ka caktuar seancë gjyqësore me datë 10.03.2017 në të cilën ka prezentuar përfaqësuesi i paditëses Driton Rexhepi si dhe i padituri M. H.

I autorizuari i paditëses ka bërë precizimin e kërkesëpadiës, ne kuptimin objektiv ku e ka zvogëluar lartësinë e borxhit nga shuma prej 1.821.74 €,në shumën prej 877.43€,pasi që borxhi i precizuar është llogarit për periudhën kohore prej datës 01.01.2009 deri më 20.04.2013, dhe precizimin e kishte bërë duke u bazuar në listën zyrtare të publikuar nga KEDS, ku i padituri ka përfutuar nga falja në shumë prej 1099.87€, me kusht sipas nenit 4 të Ligjit të faljes së borxheve publike tani i padituri duhet të paguaj shumën e borxhit në vlerë 877.43€, duke i propozuar gjykatës që pas administrimit të provave ta detyroj të paditurin në përmbushjen e borxhit të lartëcekur si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës për taksë gjyqësore në vlerë prej 20 €.

I padituri M.H. në seancën gjyqësore te datës 10.03.2017, nuk e kundërshtuar precizimin e kërkesëpadiës dhe ka deklaruar se është e vërtetë se ka borxh me KEK-un ,mirëpo te njëjtën nuk ka mundur te paguaj per shkak te kushteve ekonomike pasi qe është pensioner dhe realizon te ardhura mujore vetëm prej 75 €, dhe pa të ardhura të tjera për familjen e tij.

## **Gjykata ka administruar këto prova**

*Leximi dhe shtjellimi i faturës së konsumatorit me nr.... në emër të M. H. të datës 04.09.2012.*

*Leximi i transaksioneve të konsumatorit në emër të M. H me numër ...të datës...,*

*Leximi i transaksioneve për transaksionet e konsumatorit me shifër ...e datës...,*

*Leximi i listës së publikuar nga KEK.sh.a. mbi faljen e borxhit.*

## **Vlerësimet juridike dhe faktike të gjykatës .**

*Me shtjellimin dhe vlerësimin e provave, gjykata e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike sipas të cilës është vërtetuar se i padituri nuk e ka paguar borxhin e shfrytëzimit të energjisë elektrike paditëses fakt i cili u vërtetua përmes transaksionit të konsumatorit ....e datës 10.03.2017. Po ashtu në bazë të transaksioneve në emër të paditurit M. H me numër ..të datës 21.09.2012, gjykata vërtetoi se borxhi i më hershëm është falur duke u bazuar në listën e publikuar nga KEK.sh.a mbi faljen e borxhit.*

*Nga të cekurat e lartshënuara u vendos si në diapozitivin e këtij aktgjykimi.*

*Në bazë të nenit 452.1 të LPK-ës, gjykata e detyroj të paditurin që të paguaj paditëses shumën prej 20 € në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore .*

*Nga të cekurat më lartë në bazë të nenit 143 të LPK-ës Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

## **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

**Me dt.10.03.2017**

**Gjyqtarja**  
**Mevlide Shabani**

**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit, në Prishtinë, në afat prej 15 nga pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftuara përmes të kësaj gjykate.